



"Prag"

Pjesë sociale e dramaturgjike, kushtuar sfidës së grave të dhunuara shqiptare, në kërkim të identitetit të tyre, me ndihmën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

Përgatiti: Ben Andoni
Udhëheqëse Artistike: Aneta Malaj

Pjesa social-teatrale "Prag" po shfaqet me sukses në disa njësi vendore të vendit. Këto aktivitete organizohen nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e zbatimit të projektit "Forcimi i grave në nevojë dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit në adresimin e diskriminimit gjinor dhe dhunës në familje përmes dramaturgjikimit dhe performancës", i cili mbështetet nga Civil Rights Defenders, partner në projekt. "Prag" do të shfaqet në rrethet Tiranë, Lezhë dhe Vlorë.

Aktiviteti i parë u organizua në datën 10 Dhjetor 2014, në ditën e mbylljes së fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, në ambientet e Shkollës së Mesme "100 Vjetori i Pavarësisë", në Kashar Qendër, Tiranë. Morën pjesë rreth 70 të ftuar, nxënës mësues e prindër, të cilët ndoqën shfaqjen me mjaft interes dhe në përfundim të saj zhvilluan diskutime aktive mbi çështjet që trajtoheshin në këtë pjesë.

Në vijim, do të organizohen aktivitete të ngjashme në datën 15 Dhjetor, ora 10.00, në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Lezhë dhe në datën 17 Dhjetor, ora 10.00, në ambientet e Bashkisë Vlorë, me komunitetin dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme.



Foto nga shfaqja "Prag", në ambientet e Shkollës së Mesme "100 Vjetori i Pavarësisë", në Kashar Qendër, Tiranë